



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4342/prot.
3

Rrogozhinë, më 16.10.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Titulli : Konsultim me publikun për Planin Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028

Propozues të projektakteve : Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social.

Qëllimi : Ky bashkëbisedim me banorët e komunitetit ka për qëllim mbledhjen e rekomandimeve, sugjerimeve, mendimeve në lidhje me miratimin e Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028. Për të kuptuar problematikat e qytetarëve dhe prioritetet për investime apo ndërhyrje të ndryshme nga ana e Bashkisë për rregullimin e cilësisë së jetës duke bërë nëse është e mundur ndryshime direkte në draftin e Planit Social vendor për vitin 2025-2028.

Gjithashtu rekomandimet janë të mirëpritura të dërgohen në adresën e emailit:
visi.shera85@gmail.com

Janë të ftuar të marrin pjesë :

Nga Bashkia : Kryetari i Bashkisë, Kryetarja, Anëtarët dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak, Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj, Drejtori i zyrës së Mirëqënies Sociale dhe Grupi i Punës që hartoi dhe propozon projektaktin, Koordinatorja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Nga Komuniteti : Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarët e biznesit, gazetarë, media etj.

Takimi zhvillohet ditën e Hënë datë 28.10.2024 ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak kati i dytë, ish Bashkia Rrogozhinë lagja nr.1, rruga e Kavajës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARE E KËSHILLIT

MUKADES GIXHARI

KRYETARI I BASHKISË

EDISON MEMOËLLA

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË
Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. ____ Prot.

Rrogozhinë, më ____/____/2024

Plani Social Vendor

2025-2028

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
I. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE	4
1. Vizioni.....	4
2. Misioni	4
3. Parimet e Planit Social Vendor	4
II. ANALIZA E SITUATËS	6
Kuadri strategjik	6
Niveli i Realizimit të Planit Social Ekzistues	7
Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet	7
I. Vlerësimi i nevojave.....	7
II Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve	24
III Boshllëqet – nevojat e paplotësuara për kujdes social dhe shërbimet.....	27
IV Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta	29
Pikat e Forta:	33
Pikat e Dobëta:	33
Mundësitë:	34
Rreziqet:	34
III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	34
IV. PLANI I VEPRIMIT	25
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	1
VI. ANEKSI 1 - TABELAT	2



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Rrogozhinë, zbatuar nga GOPA Eorldeide Consultants.

HYRJJE

Bashkia Rrogozhinë, e vendosur në qendër të Shqipërisë, përballet me një sërë sfidash për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe dinamizmit demografik. Ajo përfshin pesë njësi administrative: Rrogozhinë, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë. Kufijtë e saj shtrihen në veri me bashkinë Kavajë, në veri-lindje me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Lushnje, në lindje me bashkinë Peqin, dhe në perëndim me detin Adriatik. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Rrogozhinës.

Sipas Censurit të vitit 2023, popullsia e Bashkisë është 12,567 banorë, ndërsa të dhënat nga Regjistri i Gjendjes Civile tregojnë një numër më të lartë prej 42,732 banorësh. Kjo diferencë tregon për migrimin e lartë dhe ndikimin e tij në strukturat sociale dhe ekonomike të bashkisë.

Ekonomia e Bashkisë Rrogozhinë është e bazuar kryesisht në bujqësi dhe blegtori, me 68% të popullsisë që jeton në zona rurale. Megjithatë, ajo përballet me sfida të mëdha në plotësimin e nevojave sociale, ekonomike dhe shëndetësore të popullsisë. Buxheti i vogël i bashkisë për kujdesin social nuk është i mjaftueshëm për të përballuar kërkesat në rritje, veçanërisht për të moshuarit, fëmijët dhe komunitetet vulnerabël si romët dhe egjiptianët, të cilët përbëjnë 1.36% të popullsisë. Shërbimet sociale janë të kufizuara dhe aktualisht ofrohet vetëm një shërbim lëvizës për personat me aftësi të kufizuara, i cili mbulon një numër të vogël individësh.

Përveç kufizimeve financiare, sfidat demografike përfshijnë plakjen e popullsisë dhe reduktimin e ndjeshëm të grupmoshës 0-14 vjeç, e cila ka rënë me mbi 56%. Kjo situatë ka shkaktuar një dobësim të kapaciteteve të ardhshme të fuqisë punëtore. Investimet urgjente janë të nevojshme, veçanërisht në shërbime sociale dhe infrastruktura shëndetësore për të moshuarit. Rritja e dhunës në familje dhe mungesa e strehimit social janë sfida të tjera të rëndësishme.

Megjithatë, Bashkia Rrogozhinë ka potencial për zhvillim turistik falë afërsisë me detin dhe pasurive kulturore. Por, burimet financiare të kufizuara ngadalësojnë përparimin në këtë fushë. Kjo situatë kërkon qasje inovative për të siguruar që strategjitë për zhvillimin ekonomik dhe shërbimet sociale të jenë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, duke mbajtur parasysh nevojat e grupeve vulnerabël.

Në këtë kontekst, Bashkia Rrogozhinë ka nisur një proces strategjik për hartimin e një plani social të integruar, duke përfshirë të dhënat e cens 2023 dhe regjistrin civil 2024 si bazë për vendimmarrje më të mirë informuar. Përfshirja e grupeve të interesuara në këtë proces, si dhe analizat e detajuara të situatës socio-ekonomike të popullsisë, janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe përballimin e sfidave që lidhen me plakjen e popullsisë dhe zhvillimin ekonomik të balancuar.

Plani social i Bashkisë Rrogozhinë është një instrument i rëndësishëm jo vetëm për të përmbushur detyrimet ligjore, por edhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Ai ofron një mundësi për të artikuluar qartë nevojat dhe prioritetet e bashkisë, duke e bërë atë një mjet strategjik për të tërhequr mbështetje financiare nga donatorët dhe për të garantuar aksesin e barabartë në shërbime bazë për të gjithë banorët. Prosesi i hartimit të Planit Social është realizuar përmes një metodologjie të mirëstrukturuar, duke përfshirë mbështetje nga ekspertë dhe angazhimin e plotë të stafit të bashkisë dhe aktorëve lokalë, duke siguruar kështu një kuptim të thellë të sfidave dhe nevojave sociale.

I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.Vizioni

Vizioni i Planit Social Vendor të Bashkisë Rrogozhinë është krijimi i një mjedisi mundësues dhe gjithëpërfshirës që garanton një jetesë dinjitoze dhe qasje në shërbime sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë, në përputhje me nevojat specifike të tyre në çdo njësi administrative. Ky vizion përfshin dhe adreson edhe nevojat e komuniteteve rome dhe egjiptiane, duke synuar fuqizimin dhe integrimin e plotë shoqëror të këtyre grupeve.

Ky Vizion, i ndërtuar mbi parimet e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, ka një fokus të veçantë në mbështetje edhe të komuniteteve rom dhe egjiptiane, duke adresuar nevojat specifike të këtyre grupeve në nivel lokal. Ai synon të krijojë mundësi për rintegrim dhe fuqizim të të gjithë komuniteteve në nevojë.

2.Misioni

Misioni i Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë është të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të integruar dhe gjithëpërfshirës shërbimesh sociale, që përmirëson kushtet e jetesës dhe siguron mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin e të gjithë qytetarëve, veçanërisht grupeve vulnerabël si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet me të ardhura të ulëta, fëmijët, të rinjtë, viktimat e dhunës dhe trafikimit, dhe komunitetet rome dhe egjiptiane. Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike dhe sektorin privat, plani synon të krijojë mundësi për rintegrim dhe fuqizim të këtyre grupeve, duke respektuar identitetin e tyre kulturor dhe duke garantuar një jetesë dinjitoze dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë individët në çdo njësi administrative të bashkisë.

3.Parimet e Planit Social Vendor

Parimet që udhëheqin Planin Social të Bashkisë Rrogozhinë janë themelore për sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes sociale. Ky plan synon të garantojë përfshirje të plotë dhe barazi për të gjithë qytetarët, duke u fokusuar veçanërisht tek grupet më vulnerabël dhe minoritetet. Në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare, plani respekton të drejtat e njeriut, identitetin kulturor dhe universalitetin, ndërsa promovon transparencën, efektivitetin dhe qeverisjen e mirë. Bashkëpunimi dhe partneritetet me aktorët lokalë dhe kombëtarë janë kyçe për realizimin e suksesshëm të këtyre objektivave. Disa nga parimet kryesore që përfshihen në këtë Plan janë:

Përfshirja dhe barazia: Sigurimi i përfshirjes së plotë dhe barazisë për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Ky parim synon jo vetëm të eliminojë diskriminimin, por të sigurojë që të gjitha grupet të kenë akses të barabartë në shërbime dhe mundësi. Masat e propozuara përfshijnë krijimin e programeve specifike për përfshirjen e këtyre komuniteteve dhe sigurimin e asistencës sociale të vazhdueshme.

Përqendrimi në grupe vulnerabël: Plani ofron mbështetje specifike për grupet vulnerabël si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet me të ardhura të ulëta, fëmijët dhe të rinjtë, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe komunitetet rome dhe egjiptiane. Për të siguruar

mbështetje efektive, propozohet krijimi i databazave të përditësuara për secilin grup, për të identifikuar dhe adresuar nevojat e tyre reale.

Respektimi i të drejtave të njeriut: Promovimi i dinjitetit dhe respektimi i të drejtave themelore të çdo individi, duke siguruar përfshirjen e plotë të të gjithë qytetarëve në shoqëri. Një fokus i veçantë i këtij parimi është mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël, përmes masave që sigurojnë trajtim të drejtë dhe akses në shërbime.

Përputhshmëria me standardet kombëtare: Plani social do të harmonizohet plotësisht me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 dhe me standardet ligjore kombëtare. Masat konkrete do të përfshijnë krijimin e mekanizmave të rregullt të monitorimit për të siguruar përputhshmërinë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Transparenca dhe efektiviteti: Proceset e vendimmarrjes dhe zbatimit duhet të jenë të qarta dhe të hapura për publikun. Transparenca do të sigurohet përmes publikimit të rregullt të raportimeve dhe përfshirjes së komunitetit në proceset vendimmarrëse. Për të rritur efektivitetin, plani përfshin ngritjen e mekanizmave të matjes së performancës së shërbimeve sociale.

Bashkëpunimi dhe koordinimi: Plani do të realizohet përmes një bashkëpunimi të ngushtë me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e komunitetit. Krijimi i grupeve të punës ndërsektoriale për koordinimin e shërbimeve sociale është një masë konkrete që synon të sigurojë qasje të koordinuar dhe efektive.

Përfshirja sociale dhe universaliteti: Synohet që të gjithë individët të kenë akses të barabartë në shërbime sociale dhe që asnjë grup të mos përjashtohet. Për të arritur këtë qëllim, do të hartohen politika që mbështesin aksesin e barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjendjes sociale apo ekonomike.

Respektimi i identitetit kulturor: Respektimi i identitetit kulturor të minoriteteve rome dhe egjiptiane është një parim kyç për të siguruar përfshirjen e tyre të plotë në jetën shoqërore dhe ekonomike. Plani social propozon programe që nxisin ruajtjen e kulturës dhe traditave të këtyre minoriteteve, ndërkohë që integrimi i tyre në jetën e përditshme mbetet një përparësi.

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Partneritetet me organizata joqeveritare, sektorin privat dhe aktorë të tjerë janë të rëndësishme për arritjen e objektivave sociale. Këto bashkëpunime do të forcojnë burimet financiare dhe ekspertizën, duke siguruar zbatimin e suksesshëm të masave sociale.

Trajtimi i varfërisë dhe pabarazisë: Luftimi i varfërisë dhe pabarazisë mbetet një qëllim themelor. Do të ndërmerren veprime të drejtpërdrejta për të zvogëluar pabarazitë ekonomike dhe shoqërore përmes programeve të ndihmës dhe trajnimit për aftësimin profesional të grupeve në nevojë.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Përparimi drejt një zhvillimi social të qëndrueshëm kërkon që masat e planit të kenë një ndikim pozitiv afatgjatë mbi mirëqenien e individëve dhe komunitetit. Plani synon të krijojë mekanizma që nxisin zhvillimin ekonomik të komunitetit, duke përmirësuar kushtet e jetesës dhe ulur varfërinë.

Integrimi i shërbimeve sociale në zhvillimin e territorit: Shërbimet sociale do të integrohen në zhvillimin e përgjithshëm të territorit, për të siguruar që zhvillimi ekonomik dhe social të ecin paralelisht. Kjo përfshin përfshirjen e strategjive sociale në planifikimin urban dhe zhvillimin e infrastrukturës.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale: Ruajtja e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale të përfituesve të shërbimeve është thelbësore. Do të implementohen protokolle të qarta për të siguruar që të dhënat personale të trajtohen me përgjegjësi dhe në përputhje me ligjin.

Qeverisja e mirë: Transparenca, pjesëmarrja e qytetarëve dhe llogaridhënia janë elemente të domosdoshme për një qeverisje të mirë. Plani do të përfshijë mekanizma për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, si dhe raportime të rregullta për të garantuar që zbatimi i planit të jetë i ndjekshëm dhe i monitoruar.

Këto parime janë themeli mbi të cilin Bashkia Rrogozhinë synon të ndërtojë një shoqëri të drejtë dhe të barabartë, ku çdo individ ka qasje të barabartë në shërbime dhe mbështetje sociale. Duke ndjekur këto udhëzime, plani synon të përmirësojë cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët, duke garantuar përfshirje dhe zhvillim të qëndrueshëm.

II. ANALIZA E SITUATËS

Kuadri strategjik

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAË

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:

- Strategjia Territoriale Bashkia Rrogozhinë;
- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Rrogozhinë.


Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet

I. Vlerësimi i nevojave

1.1 Të dhënat demografike

Analiza demografike e Bashkisë Rrogozhinë është realizuar duke u bazuar në të dhënat e marra nga dy censuset, ai i vitit 2011 dhe censusi i vitit 2023, si dhe nga të dhënat e nxjerra nga Regjistri i Gjendjes Civile për periudhat maj 2022 dhe maj 2024. Këto burime ofrojnë një pasqyrë të plotë të ndryshimeve në strukturën dhe shpërndarjen e popullsisë në bashki, duke shërbyer si bazë për ndërtimin e analizës së Planit Social Vendor, i cili synon të adresojë në mënyrë të qëndrueshme sfidat demografike dhe sociale të këtij territori.

Bazuar në të dhënat e **Censuseve 2011 dhe 2023**, Bashkia Rrogozhinë ka pësuar një tkurrje të ndjeshme të popullsisë gjatë kësaj periudhe.




Nga 22,148 banorë në vitin 2011, numri i banorëve ka rënë në 12,567 në vitin 2023, duke shënuar një ulje prej 43%. Kjo rënie e ndjeshme reflektohet në të gjitha grupmoshat ku grupmosha 0-14 vjeç ka pësuar një ulje prej mbi 56%, nga 3,644 në 1,592 banorë; grupmosha 15-64 vjeç ka pësuar një ulje prej rreth 46%, nga 14,441 në 7,832 banorë; ndërsa grupmosha mbi 65 vjeç ka pësuar një rënie më të lehtë prej rreth 23%, nga 4,063 në 3,133 banorë. Këto të dhëna tregojnë një tkurrje të vazhdueshme të popullsisë së bashkisë në të gjitha grupmoshat, veçanërisht


midis fëmijëve dhe të rinjve

Nga të dhënat e **Regjistrit të Gjendjes Civile** për vitet 2022 dhe 2024, rezulton se Bashkia Rrogozhinë ka përjetuar një rritje të lehtë në numrin e familjeve me 3.55%, nga 10,960 në 11,394 familje.

Shpërndarja territoriale e popullsisë tregon një raport të njëjtë midis zonave urbane dhe rurale në të dy vitet. Rreth 32% e familjeve jetojnë në qytetin e Rrogozhinës, ndërsa pjesa tjetër është e përqendruar në zonat rurale: 21% në Kryevidh dhe në Lekaj, 20% në Gosë dhe 6% në Sinaballaj. Ky raport tregon një nevojë për politika të zhvillimit të qëndrueshëm, që do të siguronin mundësi dhe shërbime të barabarta për të gjitha zonat.




Numri mesatar i anëtarëve për familje rënë nga 3.89 në vitin 2022 në 3.77 në vitin 2024, duke treguar një prirje drejt familjeve më të vogla



Rritja e popullsisë totale ka qenë minimale, vetëm 0.34%, duke kaluar nga 42,588 banorë në vitin 2022 në 42,732 banorë në vitin 2024. Në analizën e ndryshimit të popullsisë ndër vite, disa njësi administrative kanë përjetuar rënie në numrin e banorëve, siç është Rrogozhina me 189 banorë më pak dhe Kryevidhi me 78 banorë më pak. Në të kundërt, njësitë si Gosë dhe Lekaj kanë shënuar rritje, përkatësisht me 100 dhe 308 banorë. Ndërsa njësia administrative Sinaballaj ka ruajtur të njëjtin numër banorësh.

Struktura demografike e Bashkisë tregon një popullsi në moshë pune, ku 62% e banorëve janë në grupmoshën 19-64 vjeç, duke përfaqësuar forcën punëtore kryesore dhe shtyllën ekonomike të zonës. Ndërkohë, 24% e popullsisë përbëhet nga fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 18 vjeç, një tregues i rëndësishëm për nevojën e investimeve në arsim dhe shërbime për të rinjtë. Pjesa e popullsisë mbi 65 vjeç është 14%, duke reflektuar një komponent të konsiderueshëm të të moshuarve, që kërkon politika të posaçme për kujdesin social dhe shërbimet shëndetësore. Kjo strukturë sugjeron një përqendrim të masave politike për të mbështetur rininë dhe forcën punëtore, ndërsa gjithashtu përgatit terrenin për një plakje të popullsisë në të ardhmen.



Duke analizuar strukturën e popullsisë në vite rezulton se fëmijët 0-6 vjeç kanë pësuar një rënie prej 1.4%, ndërsa grupmosha 7-15 vjeç është rritur me 2%. Në të kundërt, grupmosha 16-18

vjeç ka parë një ulje të theksuar prej 7.81%. Popullsia e grupmoshës 19-64 vjeç, që përfaqëson forcën punëtore aktive, ka shënuar një rritje prej 2.17%, ndërsa grupmosha mbi 65 vjeç ka pësuar një rënie prej mbi 4%. Këto ndryshime reflektojnë një ristrukturim të popullsisë dhe sugjerojnë nevojën për politika specifike për ruajtjen e stabilitetit demografik.

Të dhënat zyrtare mbi numrin e familjeve dhe banorëve të komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë Rrogozhinë mungojnë, duke krijuar një boshllëk në informacionin demografik për këto grupe. Sipas regjistrimit të realizuar nga vetë Bashkia, rezulton se 183 familje, ose 1.61% e të gjitha familjeve në bashki, i përkasin këtyre komuniteteve. Me një popullsi totale prej 586 banorësh, komuniteti rom dhe egjiptian përbën vetëm 1.36% të popullsisë së përgjithshme të bashkisë, duke reflektuar një përqindje të vogël dhe të marginalizuar në raport me shumicën.

Analiza demografike e Bashkisë Rrogozhinë tregon një transformim të dukshëm të strukturës së popullsisë, me një ulje të konsiderueshme të numrit të banorëve në të gjitha grupmoshat, veçanërisht te fëmijët dhe të rinjtë. Ndërkohë, ka një rritje të lehtë në numrin e familjeve dhe një ruajtje të popullsisë në moshë pune, e cila ofron një bazë për mbështetje ekonomike dhe sociale në të ardhmen. Në këtë kontekst, është thelbësore të theksohet se komuniteti rom dhe egjiptian, i cili përbën një përqindje të vogël të popullsisë totale, ka nevojë për politika dhe masa specifike që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës dhe inkurajojnë vetëdeklarimin e tyre pranë strukturave shtetërore për një përfshirje të plotë në zhvillimin social-ekonomik të bashkisë. Për të adresuar sfidat e tkurrjes së popullsisë dhe për të ruajtur një strukturë të balancuar demografike, është e domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin social dhe ekonomik që synon përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, mbështetjen e të rinjve dhe përgatitjen për një shoqëri në plakje.

1.2 Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale

1.2.1 Ndhimja Ekonomike për familjen në nevojë

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Bashkia Rrogozhinë garanton mbështetje me pagesa mujore në CASH për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme nëpërmjet:

- i) Fondit të Ndhmës Ekonomike (NE);¹
- ii) Fondit 6% (si pjesë shtesë e NE)² dhe;
- iii) Fondeve të veta të bashkisë.³

Ndhimja ekonomike për familjet në nevojë në Bashkinë Rrogozhinë është një komponent thelbësor i politikave sociale, i cili synon përmirësimin e kushteve të jetesës për grupet më vulnerabël. Analiza e skemave të ndihmës ekonomike për vitin 2024 tregon përkushtimin e vazhdueshëm për të mbështetur familjet në nevojë, me qëllim reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.

Përmbushja e qëllimeve është një aspekt kyç i skemave të ndihmës ekonomike, të cilat mbështesin familjet që përballen me vështirësi financiare. Ndhimja përfshin familje në nevojë

¹ Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë,”

² Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë,”


³ Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë,” Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë,”

si dhe kategori si gratë kryefamiljare, fëmijët jetimë dhe viktimat e dhunës. Në maj 2024, Bashkia Rrogozhinë mbështeti me pagesa mujore në cash 229 familje nga tre skemat e ndihmës, që përbën 2% të totalit të familjeve në bashki. Krahasuar me vitin 2022, ku 288 familje përfituan nga ndihma ekonomike, rezultojnë një rënie prej mbi 25% në numrin e familjeve përfituese nga skema e Ndihmës Ekonomike (NE), dhe një ulje prej 16% në numrin e familjeve që përfitojnë nga Fondi 6%. Ndërkohë, numri i familjeve që përfitojnë nga fondet e veta të bashkisë është rritur me mbi 53%. Në vitin 2024, Bashkia ka ndarë nga buxheti i saj një fond prej 1,220,000 lekësh për ndihmën ekonomike, që përbën dyfishin e fondit që bashkia ka shpërndarë për këtë qëllim në vitin 2023.

Sipas të dhënave:

- ✓ 81% e familjeve në nevojë mbështeten me ndihmë në cash nga skema e NE
- ✓ 9% përfitojnë nga Fondi 6%
- ✓ 10% nga skema mbështetëse e fondeve të vetë bashkisë.

Nga familjet përfituese, 53% banojnë në njësinë administrative Rrogozhinë (qytet), ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në zonat rurale (Gose 23%; Lekaj 10%; Sinaballaj 7% dhe Kryeviidh 7%).



Struktura e grupmoshave të anëtarëve të familjeve përfituese të NE⁴ në Bashkinë Rrogozhinë tregon se shumica dërrmuese e përfituesve (62%) janë të rritur të moshës 19-67 vjeç, duke reflektuar nevojën për politika që synojnë fuqizimin ekonomik dhe punësimin për këtë grup. Fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë së bashku 21% të përfituesve, me 8% të moshës 0-15 vjeç dhe 13% të

moshës 15-18 vjeç, duke treguar rëndësinë e investimeve në arsim dhe mbështetje sociale për këta grupmosha. Ndërkohë, të moshuarit mbi 67 vjeç përfaqësojnë 9% të përfituesve, duke nënvizuar nevojën për shërbime mbrojtëse dhe mbështetje të posaçme për këtë kategori.

Për familjet përfituese nga Fondi 6% dhe fondet e veta të bashkisë, Këshilli Bashkiak ka hartuar kritere specifike që favorizojnë familjet me gra kryefamiljare, të cilat zënë 50% e familjeve përfituese.

Përveç ndihmës për familjet, Bashkia Rrogozhinë ndihmon edhe kategori të veçanta:

- ✓ 10 fëmijë me status jetimi, një rritje prej 7 fëmijësh krahasuar me vitin 2022
- ✓ 15 viktimat e dhunës gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, krahasuar me 10 viktimat në vitin 2023
- ✓ 1 fëmijë mbështetet në shërbim alternativ (familje kujdestare), pa ndryshime për tre vitet e fundit.

⁴ Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë,"

- ✓ Rreth 38 familje të komuniteteve rome dhe egjiptiane, që përbëjnë mbi 20% të këtyre komuniteteve në bashki, përfitojnë pagesa mujore në cash nga të tre skemat mbështetëse, duke përbërë 16.6% të përfituesve të ndihmës në nivel bashkie.

Analiza tregon një përkushtim të veçantë për të ndihmuar grupet më vulnerabel, përfshirë gratë dhe fëmijët. Qeverisja lokale është e angazhuar të sigurojë mbështetje të mjaftueshme dhe të orientuar nga nevojat specifike të këtyre grupeve.

Menaxhimi i skemës së Ndhmës Ekonomike realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Rrogozhinë, në bashkëpunim me administratorët shoqërorë në çdo njësi administrative. Dyfishimi i fondeve të bashkisë është një hap pozitiv, por nevojiten përmirësime në efektivitet dhe shtrirje të mbulimit. Rritja e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimi i komunikimit me publikun do të ndihmojnë në lehtësimin e aksesit dhe përmirësimin e transparencës.


1.2.2 Punëkërkesit e papunë

Aktualisht, Bashkia Rrogozhinë përballet me një situatë të pasigurt në lidhje me papunësinë, për shkak të mungesës së të dhënave të plota nga Zyra Vendore e Punësimit mbi këtë çështje. Në vitin 2024, në zyrën e punësimit janë regjistruar 892 persona si punëkërkes të papunë (PUPA), prej të cilëve 502 janë gra dhe vajza, që përbëjnë 51.15% të totalit. Ky numër përfaqëson 2.3% të popullsisë totale të bashkisë, duke treguar një prani të konsiderueshme të papunësisë.

Karakteristika PUPA:

- a) 195 persona, ose mbi 19% e totalit të PUPA-s, kanë aftësi të kufizuar. Kjo përqindje e lartë tregon një grup të veçantë të popullsisë që përballet me sfida të mëdha në gjetjen e punës.
- b) 97 persona, që përbëjnë rreth 10% të totalit të PUPA-s, janë anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, duke reflektuar vështirësitë e këtij grupi në tregun e punës.
- c) 637 persona (65% e totalit të PUPA-s) vijnë nga familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike. Regjistrimi i tyre si punëkërkes është një kërkesë ligjore për përfitimin e NE. Kjo tregon se një pjesë e madhe e punëkërkesve është e motivuar nga nevoja për të përmbushur kërkesat e përfitimit të ndihmës ekonomike, dhe jo domosdoshmërisht nga kërkimi aktiv i një vendi pune.

Shpërndarja e papunësisë në Bashkinë Rrogozhinë përfshin si zonat urbane, ashtu edhe ato rurale, duke reflektuar sfida të përbashkëta dhe nevoja specifike për mbështetje dhe ndërhyrje të synuara.



46% e PUPA-s jetojnë në qytetin e Rrogozhinës, që tregon një përqendrim të lartë të papunësisë në zonën urbane ndërsa 54% e PUPA-s jetojnë në zonat rurale. Më konkretisht, 22% në njësinë administrative Gose, 18% në njësinë Lekaj, 11% në Kryevidh, dhe 3% në Sinaballaj. Kjo shpërndarje tregon se papunësia prek në mënyrë të konsiderueshme edhe zonat rurale,

duke krijuar një sfidë për mundësitë ekonomike dhe zhvillimin lokal.

Njësia Administrative	Numri personave punëkërkuar të papunë (PUPA)	Numri i PUPA që përfitojnë NE		
		Total	Gra dhe vajza	Burra dhe djem
Rrogozhine	452	314	164	150
Sinaballaj	34	24	12	12
Gose	215	159	78	81
Lekaj	173	94	49	45
Kryevidh	108	46	23	23
Total	982	637	326	311

Sikurse shihet nga tabela e mësipërme, mungojnë të dhënat për grupmoshat, kategoritë e tjera në nevojë dhe nivelin arsimor të PUPA-s, duke penguar një analizë të plotë dhe specifike të situatës së papunësisë. Gjithashtu, Zyra e Punësimit nuk ka regjistruar asnjë person nga Bashkia Rrogozhinë në ndjekje të kurseve të formimit profesional. Kjo tregon një mungesë të qasjes ose interesit për formim profesional, duke nënvizuar nevojën për përmirësimin e politikave dhe aktiviteteve për rritjen e aftësive të punësimit në bashki.

Për të përmirësuar situatën e papunësisë në Bashkinë Rrogozhinë, është e domosdoshme krijimi i një databaze të detajuar që përfshin informacion mbi grupmoshat, nivelin arsimor dhe kategoritë e tjera në nevojë të punëkërkuarve të papunë, duke lehtësuar kështu hartimin e politikave të targetuara. Një tjetër hap i rëndësishëm është nxitja e pjesëmarrjes në kurse të formimit profesional, për të rritur aftësitë dhe mundësitë e tyre për punësim. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi me aktorët lokalë dhe rajonalë duhet të forcohet për të krijuar më shumë mundësi punësimi, veçanërisht për grupet më të prekshme, si personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian. Këto masa do të ndihmojnë në zbutjen e papunësisë dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të bashkisë në tërësi.


1.2.3 Individë me aftësi të kufizuara

Analiza e individëve me aftësi të kufizuara (PAK) që përfitojnë pagesën për shkak të aftësisë së kufizuara në Bashkinë Rrogozhinë ofron një pasqyrë të detajuar të situatës së këtij grupi të popullsisë, duke theksuar sfidat dhe mundësitë për përmirësim. Individët me aftësi të kufizuara përballen me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale, ose ndijore, të cilat, së bashku me barrierat mjedisore dhe shoqërore, ndihmojnë në pengimin e pjesëmarrjes së tyre të plotë në shoqëri në kushte të barabarta. Legjislacioni shqiptar garanton të gjithë shtetasve të

Shqipërisë të drejtën për të përfituar një pagesë mujore, e cila vlerësohet nga komisionet përkatëse, për të mbështetur këtë grup në përballimin e vështirësive të përditshme.

Analiza e të dhënave tregon një situatë relativisht të qëndrueshme, megjithatë, ka ndryshime të dukshme në shpërndarjen e përfitimeve dhe aksesin në shërbime për individët me AK. Në maj të vitit 2024, numri i PAK të njohur zyrtarisht arriti në 886 persona, që përfaqëson 2.07% të popullsisë së përgjithshme të bashkisë. Nga këta, 50.1% janë invalidë pune, 30.3% janë të paaftë sipas vlerësimit bio-psiko-social, 8.5% janë të verbër, dhe 5.1% janë para dhe tetraplegjikë. Pavarësisht një numri të qëndrueshëm të përfituesve krahasuar me vitin 2022 (ku ishin 888 persona me AK), pagesa mesatare mujore për shkak të AK ka pasur një rritje të ndjeshme prej 14.95% në vitin 2024, duke arritur në 9,227 lekë, nga 8,027 lekë në vitin 2022. Kjo rritje lidhet me politikat qeveritare për rritjen e pagesave, veçanërisht për të verbrit dhe individët me AK sipas vlerësimeve të komisioneve bio-psiko-sociale.

Shpërndarja e përfituesve sipas zonave të banimit tregon se 69% e PAK jetojnë në zonat rurale, ndërsa 31% në qytetin e Rrogozhinës.



Kjo tregon një prani të lartë të personave me aftësi të kufizuara në zonat rurale, duke reflektuar sfidat me të cilat përballen këta individë për aksesin në shërbimet publike dhe mundësitë ekonomike.

Për më tepër, 8.8% e përfituesve janë të mitur (0-18 vjeç), ndërsa 91.2% janë të rritur (19 vjeç e lart). Vetëm një i mitur është i para dhe tetraplegjik, ndërsa 77 të tjerë janë të mitur të vlerësuar me AK sipas komisionit shumëdisiplinar për vlerësimin bio-psiko-social. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se të gjithë personat e verbër janë mbi 18 vjeç.

119 persona me AK përfitojnë shërbimin e ndihmësit personal. Numri i personave përfitues të ndihmësit personal ka shënuar një rritje prej 2.6% nga viti 2022 në vitin 2024. Shumica e përfituesve të Ndihmsit Personal janë para dhe tetraplegjikë (40%) ose të verbër (15%), ndërsa pjesa tjetër (45%) përfshin persona të tjerë me AK.

10 persona me AK (1.13% e totalit të PAK në nivel bashkia) janë anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian.

Aksesi në shërbime shoqërore, edukuese dhe sociale për individët me AK:

Shërbime shoqërore: Bashkia Rrogozhinë ofron një shërbim të lëvizshëm për AK, që përfshin psikoterapi, fizioterapi dhe infermieri për 25 përfitues të grupmoshës 0-18 vjeç (65% vajza). Këta përfitues përfaqësojnë 0.06% të popullsisë së bashkisë, 0.25% të fëmijëve në nivel bashkie, dhe 32.05% të fëmijëve me AK në nivel bashkie.

Arsimi parashkollor: Vetëm një fëmijë me AK frekuenton kopshtin e vetëm publik në Bashkinë Rrogozhinë. Ky përfitues përfaqëson 0.30% të fëmijëve që frekuentojnë kopshtin publik në Bashki.

Arsimi 9-vjeçar: 20 fëmijë me AK ndjekin arsimin 9-vjeçar, 7 në qytet dhe 13 në njësitë administrative. Nga këta, 1 fëmijë është 0-6 vjeç, 12 janë 7-13 vjeç, dhe 6 janë 15-18 vjeç. 9 janë vajza dhe 11 djem.

Arsimi i mesëm dhe i lartë: Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm dhe të lartë në Bashkinë Rrogozhinë mbetet e kufizuar. Vetëm 6 të rinj (14-18 vjeç) me AK ndjekin arsimin e mesëm dhe 2 persona arsimin e lartë në vitin 2024. Edhe pse numri i PAK që ndjekin shkollën e mesme është trefishuar në krahasim me vitin 2022, mbetet ende shumë i ulët. Për më tepër, numri i PAK që ndjekin arsimin e lartë është ulur me 50% krahasuar me vitin 2023. Asnjë person para dhe tetraplegjik, i verbër, ose invalid pune nuk ndjek arsimin e mesëm apo të lartë, duke theksuar nevojën për masa të veçanta për të përmirësuar aksesin dhe përfshirjen e tyre në arsim.

Punësimi dhe formimi profesional: 195 individë me AK janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë zyrës së punësimit. Bashkia nuk ofron të dhëna për formimin profesional të individëve me AK.

Menaxhimi i skemës së Aftësisë së Kufizuar në Bashkinë Rrogozhinë realizohet nga Drejtoria Sociale, e cila bashkëpunon ngushtësisht me administratorët shoqërorë në çdo njësi administrative. Ky bashkëpunim është i rëndësishëm për të siguruar që çdo individ me aftësi të kufizuara të ketë akses të plotë në mbështetje dhe shërbime të nevojshme, duke kontribuar kështu në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe në garantimin e një pjesëmarrjeje më të gjerë në shoqëri.

Në përfundim, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të mbështetur individët me aftësi të kufizuara në Bashkinë Rrogozhinë, është e qartë se ka ende hapësirë për përmirësime, sidomos në aspektin e aksesit në arsim dhe shërbime të specializuara. Ndërkohë që skema e pagesës dhe shërbimeve për PAK ruan një nivel të qëndrueshëm, nevojitet një angazhim më i madh për rritjen e pjesëmarrjes së këtyre individëve në jetën sociale dhe ekonomike, duke siguruar kështu barazi dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

1.2.4 Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje

Në Bashkinë Rrogozhinë, popullsia e fëmijëve në grupmoshën 0-18 vjeç është 10,032, që përbën 23% të popullsisë totale. Kjo shifër tregon një rënie prej 1.6% krahasuar me vitin 2022, e cila i atribuohet rënies së numrit të lindjeve dhe emigrimit të popullsisë. Analiza e fëmijëve sipas grupmoshave për vitin 2024 tregon se fëmijët e grupmoshës 0-6 vjeç kanë pësuar një ulje prej 1.6%, ndërsa ata të grupmoshës 7-15 vjeç janë rritur me 2.1%. Për fëmijët 16-18 vjeç, është evidentuar një ulje prej 7.8%. Njësitë Administrative paraqesin përqindje të ndryshme të numrit të fëmijëve, duke reflektuar kështu ndarjen demografike në këtë rajon: 35% e fëmijëve

0-18 vjeç jetojnë në Njësinë Administrative Rrogozhinë (3,499 fëmijë); 23% e tyre jetojnë në Lekaj (2,290 fëmijë); 19% jetojnë në Kryevidh (1,913); 18% jetojnë në Gosë (1,890 fëmijë); ndërsa 5% e tyre jetojnë në Sinaballaj (464).

Sipas censusit të vitit 2011, 16% e popullsisë ishte në grupmoshën 0-14 vjeçare, ndërsa në vitin 2023, ky përqindje ra në 13%.

Për vitin 2024, Bashkia Rrogozhinë ka identifikuar 397 fëmijë në nevojë, që përfshijnë 2 fëmijë me shmangie dënimi, 2 në shërbim prove, 10 me statusin e jetimit, dhe 250 që jetojnë në familje me ndihmë ekonomike. Po ashtu, janë evidentuar 78 fëmijë me aftësi të kufizuara, 21 viktima të dhunës, 29 fëmijë që kanë braktisur shkollën, dhe 18 të tjerë që frekuentojnë shkollën në mënyrë të pjesshme, si dhe 7 fëmijë përdorues duhani. Këto të dhëna ilustron një situatë alarmante për disa grupe fëmijësh, që kërkojnë mbështetje të menjëhershme dhe efikase.

Të dhënat e mësipërme krahasuar me situatën në vitin 2020 tregojnë një rritje të evidentimit të kategorive të fëmijëve në nevojë. Në vitin 2020, Bashkia Rrogozhinë numëronte vetëm 634 fëmijë në nevojë, ku përfshiheshin 540 fëmijë nga familjet që përfitonin ndihmë ekonomike, 67 fëmijë që merrnin pagesë për shkak të aftësive të kufizuara, dhe 27 raste menaxhimi nga Njësia e Menaxhimit të Rastit. Bashkia nuk ofronte të dhëna për kategori të tjera të fëmijëve në nevojë, çka e bënte më të vështirë adresimin e nevojave të tyre specifike. Ndërsa në vitin 2024, evidentimi i kategorive të fëmijë në rrisht, tregon për një përmirësim në identifikimin e situatave të rënda, por gjithashtu thekson nevojën për ndërhyrje të shpejtë dhe efektive për të mbështetur këta fëmijë dhe për të siguruar një të ardhme më të mirë për ta.

Një problem thelbësor është mungesa e Organizatave Joqeveritare (OJF) lokale që mund të ofrojnë shërbime për fëmijët. Buxheti i Bashkisë është shumë i limituar, dhe shpesh punonjësit për mbrojtjen e fëmijës detyrohen të mbulojnë vetë kostot e transportit për ndjekjen e rasteve, duke vënë në rrezik efikasitetin e menaxhimit të situatave në nevojë.

Aksesi në shërbime

Çerdhe: Në Bashkinë Rrogozhinë ka vetëm një shërbim çerdhe (në të gjithë territorin) për fëmijët e grupmoshës 0-4 vjeç ku marrin shërbim 37 fëmijë (15 prej te cileve vajza)

Parashkollor dhe kopshte: 335 fëmijë (48.64% vajza) të grupmoshës 4-6 vjeç, frekuentojnë 18 kopshtet publike në Bashkinë Rrogozhinë, me 67% të tyre që jetojnë në zonat rurale. Numrit të kopshteve është i njëjti në tre vite (2022-2024) ndërsa numri i fëmijëve përfitues ka ardhur në ulje. Në vitin 2024 , 96 fëmijë me pak frekuentojnë kopshtet në krahasim me vitin 2022 , ulja në % është 22.23% me pak fëmijë në vitin 2024 në krahasim me vitin 2022. 10 fëmijë janë fëmijë që jetojnë në familje që marrin NE, 1 fëmijë është me AK, 1 fëmijë është në shërbim alternative (familje kujdestare).

Arsimi bazë (9-vjeçar) : ndjekin arsimin bazë 1,295 fëmijë (56% vajza), me një ulje të numrit të shkollave nga 16 në 14 gjatë viteve 2022-2024, që tregon për sfida të vazhdueshme në ruajtjen e cilësisë së arsimit. 262 prej tyre jetojnë në familje që përfitojnë NE, 10 fëmijë gëzojnë statusin e jetimit, 20 fëmijë janë me AK.

Arsimi i mesëm, 438 fëmijë (63% vajza) ndjekin shkollat e mesme të përgjithshme. Aksesi në arsimin e mesëm për fëmijët në zonat rurale është i lartë (67%), 164 fëmijë 15-18 vjeç jetojnë në familje përfituese të NE ndërsa mungesa e të dhënave për përfshirjen e fëmijëve me aftësi

të kufizuara në këtë nivel paraqet një sfidë. Vetëm një rast i braktisjes së shkollës është raportuar në vitin 2024, që tregon për përmirësim. Në Bashkinë Rrogozhinë mungojnë shkollat e mesme profesionale.

Ndihma Ekonomike: Një shqetësim i veçantë është masa e ulët e ndihmës ekonomike për familjet në Bashkinë Rrogozhinë, ku jetojnë 2.3% e totalit të fëmijëve 0-18 vjeç. Kjo ndihmë është e pamjaftueshme për të përballuar nevojat e fëmijëve dhe të familjeve, kërkon vëmendje dhe mbështetje shtesë.

Aksesi në shërbime për fëmijët është i kufizuar. Në të gjithë territorin e Bashkisë Rrogozhinë ka vetëm një çerdhe për fëmijët e grupmoshës 0-4 vjeç, ku frekuentojnë 37 fëmijë. Për grupmoshën 4-6 vjeç, 335 fëmijë (48.64% vajza) frekuentojnë 18 kopshte publike, duke përfaqësuar një ulje prej 22.23% krahasuar me vitin 2022. 25 fëmijë me AK përfitojnë shërbime të specializuara nëpërmjet shërbimit lëvizës financiar nga MSHMS dhe Bashkia Rrogozhinë.

Aksesi në shërbime për fëmijët nga komunitetet rom dhe egjiptian përballen me sfida të shumta në arsim dhe qasje në shërbime. 38 fëmijë rom dhe egjiptian frekuentojnë kopshtet, përfaqësues 22.5% e totalit të fëmijëve që ndjekin kopshtet. Në arsimin bazë, 203 nxënës rom dhe egjiptian ndjekin shkollat 9-vjeçare, duke përfaqësuar 11.4% të totalit. Megjithatë, përfshirja e tyre në arsimin e mesëm mbetet e ulët, me vetëm 15 nxënës që ndjekin shkollat e mesme të përgjithshme.

Për të përballuar sfidat e Bashkisë Rrogozhinë në mbështetje të fëmijëve, rekomandohet të ndërmerren disa masa të menjëhershme. Së pari, është e nevojshme të rritet buxheti për shërbimet sociale dhe përkrahjen e fëmijëve në nevojë, duke përfshirë mbështetje të tjera shtesë për familjet e tyre. Së dyti, duhet të krijohen partneritete me organizatat joqeveritare dhe institucionet lokale për të ofruar shërbime dhe mbështetje më të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara, ata viktimë të dhunës, dhe ata që janë jashtë sistemit arsimor. Së treti, është thelbësore të zhvillohen programe edukative dhe rehabilituese për fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe prinderit e tyre, duke u ofruar mundësi për të rifilluar arsimimin e tyre.

1.25 Viktima të dhunës në familje

Trajtimi dhe mbështetja e viktimave të dhunës në Bashkinë Rrogozhinë përballen me një sërë sfidash të ndërlikuara, që kanë të bëjnë me mungesën e burimeve, infrastrukturës dhe ndërgjegjësimin publik. Koordinator i Dhunës në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale luan një rol thelbësor në ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve të dhunës. Sidoqoftë, në terren, sfidat mbeten të mëdha për shkak të strukturës së dobët institucionale dhe mungesës së mbështetjes së specializuar.

Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje, sipas Protokollit të Menaxhimit të Rasteve dhe Ligjit nr. 9669, funksionon në nivel lokal, por numri i rasteve është në rritje. Në vitin 2021 u regjistruan 39 raste me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), ndërsa vetëm në gjashtëmujorin e parë të 2024 kjo shifër arriti në 44 raste. Viktimat e pajisura me Urdhër Mbrojtjeje (UM) përfitojnë mbështetje ekonomike prej 9,900 lekësh në muaj, por numri i këtyre rasteve ka rënë nga 18 në vitin 2022 në 13 në vitin 2024, duke sugjeruar një trend shqetësues të mbështetjes së pamjaftueshme për viktimat.

Të dhëna	Njësia Administrative Rrogozhinë		
	Viti 2021	Vitit 2022	Vitit 2023
UMM	39	10	44
UM	18	16	13
Viktima të dhunës sipas gjinisë dhe moshës	0	0	0
<i>Gra</i>	40	24	16
<i>Fëmijë</i>	0	0	0
<i>Të moshuar</i>	0	0	0
<i>Burra</i>	2	2	2
Karakteristika të viktimave të dhunës mbi 18 vjeç	0	0	0
<i>Të papunë</i>	0	0	0
<i>Përfitues të NE</i>	0	0	0
<i>Të Pastrehë</i>	0	0	0

Analiza e diferencës midis numrit të viktimave me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM) dhe atyre me Urdhër Mbrojtje (UM) në Bashkinë Rrogozhinë tregon një hendek të thellë në trajtimin e rasteve të dhunës. Numri i viktimave që përfitojnë nga UM është ndjeshëm më i vogël se ai i atyre që kanë UMM. Një nga arsyet kryesore për këtë është se UMM jepet në situata emergjente, kur ndihma e menjëhershme është e nevojshme për të siguruar mbrojtje, por shumë viktima ngurrojnë të raportojnë dhunën për shkak të frikës nga hakmarrja ose ndëshkimi. UM është një masë që shpesh merret pas një periudhe hetimi, duke e bërë atë më të qasshme për viktimat që ndihen të sigurt për të kërkuar mbrojtje. Kjo ndihmon në shpjegimin e numrit më të madh të viktimave me UM në krahasim me ata me UMM. Mungesa e besimit tek institucionet dhe stigma sociale që rrethon dhunën në familje gjithashtu pengon viktimat të kërkojnë ndihmë dhe të raportojnë abuzimin.

Gratë dhe vajzat përbëjnë shumicën dërrmuese të viktimave, ndërsa burrat përfaqësojnë vetëm 2 raste në tre vite, çka tregon se dhuna ndaj burrave mbetet pothuajse e paraportuar. Dhuna ndaj fëmijëve dhe të moshuarve është gjithashtu një çështje shqetësuese, veçanërisht në zonat rurale dhe ato me popullsi rome dhe egjiptiane. Raportimet nga këto komunitete janë të pakta për shkak të mentalitetit tradicional dhe varësisë ekonomike të viktimave ndaj dhunuesve.

Ndërsa Bashkia Rrogozhinë ka bërë hapa përpara duke ngritur një sistem elektronik për regjistrimin e rasteve, mungesa e një qendre të specializuar për trajtimin e dhunës në familje mbetet një hendek i madh. Stafi i bashkisë ka sfida të mëdha për të ofruar ndihmë adekuate për shkak të kufizimeve financiare dhe kapacitetit të ulët. Mungesa e organizatave të shoqërisë civile locale që ofrojnë shërbime të specializuara e bën të vështirë menaxhimin efektiv të rasteve më të ndërlikuara.

Në komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe në zonat rurale, dhuna është shpesh e paraportuar për shkak të mungesës së besimit të institucionet dhe mungesës së ndërgjegjësimit rreth të drejtave ligjore. Faktorë të tjerë, si varësia ekonomike nga abuzuesit dhe mungesa e qasjeve ndaj shërbimeve mbështetëse, e përkeqësojnë situatën. Aktivitetet e ndërgjegjësimit janë ende të pamjaftueshme, dhe ka një nevojë urgjente për fushata më të përqendruara në këto zona.

Për të përmirësuar situatën e viktimave të dhunës, është e rëndësishme që Bashkia të rrisë kapacitetet institucionale përmes planifikimit të fondeve për menaxhimin e rastit, të forcojë

bashkëpunimin me organizata lokale dhe kombëtare për të ofruar shërbime të specializuara, të zhvillojë fushata ndërgjegjësimi në komunitetet (përfshi komunitetin rom dhe egjiptian) për të rritur informimin mbi të drejtat ligjore dhe mbrojtjen, si dhe të rrisë mbështetjen financiare për viktimat, duke u ofruar atyre një bazë të qëndrueshme për pavarësi ekonomike.

Situata aktuale në Bashkinë Rrogozhinë tregon se pavarësisht përpjekjeve ekzistuese, trajtimi i viktimave të dhunës kërkon përmirësime të mëdha në kapacitetin institucional dhe burimet financiare. Zbatimi i rekomandimeve të lartpërmendura do të ishte një hap i rëndësishëm për të rritur mbështetjen për viktimat, duke siguruar që ato të marrin mbrojtjen dhe ndihmën e duhur në kohën e duhur. Ndërgjegjësimi dhe qasja më e mirë në shërbime për komunitetet më vulnerabël janë thelbësore për të ulur numrin e rasteve dhe për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe të sigurt për të gjitha viktimat e dhunës.

1.2.6 Individë/familje në nevojë për strehim social

Analiza e situatës për strehimin në Bashkinë Rrogozhinë tregon se mungesa e shërbimeve të strehimit për individët në nevojë është një problem thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e komunitetit. Aktualisht, Bashkia Rrogozhinë nuk ofron asnjë shërbim për strehimin e grupeve të cenueshme, duke përfshirë viktimat e dhunës, të moshuarit, dhe ata që përballen me varfëri ekstreme. Kjo mungesë shërbimesh kontribuon në rritjen e nivelit të pasigurisë dhe rrezikut për këto grupe, duke i lënë ata pa mbrojtje dhe pa qasje në ambiente të sigurta dhe të përshtatshme për jetesë.

Një nga arsyet kryesore për këtë situatë është mungesa e burimeve financiare dhe kapaciteteve institucionale që mund të ofronin shërbime të strehimit. Bashkia duhet të përqendrohet në krijimin e një strategjie që synon të identifikojë nevojat e popullsisë për strehim dhe të zhvillojë partneritete me organizata joqeveritare dhe institucione të tjera për të ofruar ndihmë. Pjesë e kësaj strategjie duhet të jetë gjithashtu identifikimi i mundësive për financimin e shërbimeve të strehimit, si dhe trajtimi i problemit të mungesës së informacioneve për ata që ndodhen në situata krize.


Për të adresuar këtë problem, Bashkia Rrogozhinë duhet të ndërmarrë hapa konkretë, duke përfshirë ngritjen e departamentit të strehimit që ofron mbështetje dhe shërbime për individët në nevojë. Po ashtu, është e rëndësishme të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi për të rritur informacionin mbi shërbimet e disponueshme dhe për të inkurajuar individët që të kërkojnë ndihmë. Rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë ndërkombëtare do të ndihmojë gjithashtu në zhvillimin e zgjidhjeve afatgjata për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për ata që përballen me sfida të tilla. Kjo do të kontribuonte në një bashkësi më të sigurt dhe më të qëndrueshme për të gjithë banorët e Bashkisë Rrogozhinë.

1.2.7 Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi

Situata e të moshuarve në Bashkinë Rrogozhinë paraqet një sfidë të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e politikave sociale. Sipas Censurit 2023, popullsia mbi 65 vjeç ka arritur në 3,143 persona, duke shënuar një ulje prej 22.6% krahasuar me vitin 2011. Megjithatë,

kjo ulje numerike shoqërohet me një plakje të dukshme të popullsisë, ku të moshuarit tani përbëjnë 25% të totalit të popullsisë së bashkisë, në krahasim me 18% në Censusin 2011.

Në vitin 2024, Regjistri Civil i Bashkisë Rrogozhinë tregon një ulje të numrit të të moshuarve me 4%, duke arritur në 6,159 individë mbi 65 vjeç, krahasuar me 6,417 në vitin 2022.



Gjatë hartimit të planit social, Bashkia ka evidentuar 682 të moshuar në nevojë, ku 57% e tyre janë gra dhe 43% janë burra. 40% e të moshuarve në nevojë jetojnë në qytetin e Rrogozhinës, ndërsa 60% në katër njësitë e tjera administrative, me përqindjen më të lartë në Gose dhe Kryevidh. Mungesa e shërbimeve sociale të dedikuara për këtë grupmoshë, së bashku me mungesën e një strukture ose specialisti të veçantë, paraqesin probleme të konsiderueshme.

Sipas të dhënave nga Bashkia Rrogozhinë, 183 të moshuar (26.8% e të moshuarve në nevojë) kërkojnë shërbime shoqërore, ku 68% prej tyre kërkojnë shërbime në familje dhe 32% në qendra ditore. Ndërsa 48% e atyre që kërkojnë shërbime janë gra, 52% janë burra.

Nuk ka të dhëna për të moshuar të komunitetit rom dhe egjiptian. Një pengesë e rëndësishme në adresimin e nevojave të të moshuarve romë është mungesa e deklarimit të identitetit rom dhe egjiptian në proceset e regjistrimit dhe gjatë kërkesave për shërbime. Ky problem theksohet veçanërisht për të moshuarit romë, të cilët shpesh jetojnë në kushte të vështira, por që nuk janë regjistruar si të tillë në Rregjistrin e Gjendjes Civile të Bashkisë Rrogozhinë. Kjo situatë pengon qasjen e tyre në shërbime dhe mbështetje sociale, duke i lënë ata në një pozitë të pafavorshme për të marrë ndihmën që u nevojitet.

Në Bashkinë Rrogozhinë mungojnë shërbimet shoqërore për moshën e tretë. Por ajo që vlen the theksohet është tradita e kujdesit nga të afërmit dhe fqinjët vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm. Kjo traditë është një vlerë e shtuar e cila i bashkëlidhet shërbimeve të komuniteteve fetare për këtë kategori në nevojë dhe që mund të shfrytëzohet për të ndërtuar shërbime të kujdesit në familje, duke angazhuar anëtarë të komunitetit ku jetojnë të moshuarit. Kjo qasje forcon lidhjet sociale dhe ofron mbështetje emocionale dhe praktike për individët e moshuar.

Për të përmirësuar situatën e të moshuarve, rekomandohet krijimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale të specializuara, përfshirë shërbime në shtëpi dhe mbështetje për ata që jetojnë në zona rurale. Gjithashtu, duhet të krijohet një sistem i rregullt për mbledhjen e të dhënave, që do të përfshijë edhe komunitetin rom dhe egjiptian për të identifikuar nevojat specifike dhe për të planifikuar shërbime adekuate. Promovimi i programeve të ndihmës dhe mbështetjes për të moshuarit, duke përfshirë aktivitete sociale dhe shëndetësore, do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe parandalimin e izolimit social.

Krijimi i një njësie të specializuar brenda bashkisë për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për të moshuarit është gjithashtu i domosdoshëm. Kjo njësitë do të angazhojë komunitetin dhe organizatat lokale për të ofruar mbështetje të përshtatshme për nevojat e ndryshme të kësaj grupmoshë. Bashkia aktualisht nuk disponon një pozicion pune për specialistin e moshës së tretë, pengesë kjo në zhvillimin e shërbimeve të nevojshme për këtë grupmoshë.

Gjithashtu, njësia e vlerësimit dhe referimit të nevojave akoma nuk është efektive sipas ligjit nr. 121 për shërbimet sociale, duke e bërë të vështirë identifikimin dhe trajtimin e nevojave specifike të kësaj kategorie. Kapaciteti financiar i bashkisë është i limituar, ku të ardhurat nga taksat dhe tarifrat vendore janë shumë të vogla. Kjo situatë e detyron bashkinë të kërkojë mbështetje financiare nga qeveria apo donatorë të ndryshëm për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve sociale të destinuara për të moshuarit, në mënyrë që të sigurojë mbështetje dhe kujdesin e nevojshëm për këtë grup vulnerabel.

Në përfundim, situata e të moshuarve në Bashkinë Rrogozhinë kërkon një qasje të kujdesshme dhe një angazhim të fortë për të përmirësuar shërbimet sociale dhe për të adresuar nevojat e këtij grupi në rritje. Me një plan të mirëfilltë dhe implementimin e rekomandimeve të mësipërme, është e mundur të arrihet një mbështetje më e fortë dhe më efektive për të moshuarit në këtë bashki.

1.2.8 Individë që kanë varësi nga alkooli dhe droga

Plani social i mëparshëm i Bashkisë Rrogozhinë nuk ka përfshirë të dhëna për kategoritë e individëve me varësi nga alkooli dhe droga. Gjatë hartimit të Planit Social 2024-2027 u kërkuan të dhëna nga institucionet lokale për individër që kanë varësi nga alkooli dhe droga. Vetëm Komisariati i Policisë ofroi një të dhënë që tregon se ky institucion ka evidentuar vetëm një rast përdorimi droge çdo vit gjatë periudhës 2021-2023, dhe këta individë janë të gjithë mbi 18 vjeç. Kjo situatë sugjeron se përdorimi i drogës mund të jetë i paraportuar dhe se duhet bërë më shumë për të identifikuar dhe ndihmuar këtë grup vulnerabel.

Mungesa e të dhënave për varësinë nga droga dhe alkooli krijon një hendek të rëndësishëm në planifikimin dhe implementimin e shërbimeve. Bashkia nuk mund të ndërtojë politika efektive për këtë kategori nëse nuk ka një pasqyrë të qartë të situatës. Ndërkohë, raportet e kufizuara të policisë nuk pasqyrojnë realitetin në terren, ku rastet e varësisë shpesh mbeten të paraportuara për shkak të stigmës sociale dhe frikës nga ndëshkimi.

Një nga masat e para që duhen ndërmarrë është krijimi i Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, një strukturë e cila do të sigurojë grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për përdoruesit e alkoolit dhe drogës. Kjo njësi, e parashikuar në Ligjin Nr. 121 për Shërbimet Shoqërore, do të kishte një rol thelbësor në koordinimin midis institucioneve kryesore si policia, shërbimet sociale, arsimit dhe shëndetësia. Ky koordinim do të lehtësonte ndërtimin e një baze të dhënash të besueshme dhe të përditësuar, duke mundësuar që bashkia të ketë një kuptim më të mirë të problematikës dhe nevojave të këtij grupi.

Pavarësisht mungesës së të dhënave, duhet të nënvizohet se këta individë janë një pjesë e rëndësishme e komunitetit dhe përballen me sfida të mëdha. Kjo kërkon ngritjen e një mekanizmi të qëndrueshëm monitorimi dhe ndërhyrje, i cili përfshin fushata ndërgjegjësimi për komunitetin dhe përmirësimin e qasjes në shërbime mbështetëse. Një qasje e integruar, që kombinon shërbime psikologjike, mbështetje ekonomike dhe shërbime mjekësore, është e

domosdoshme për të ndihmuar personat me varësi dhe për të parandaluar përkeqësimin e situatës së tyre.

Për të përmirësuar mbështetjen ndaj personave me varësi në Bashkinë Rrogozhinë, duhet të ndërmerren disa hapa të rëndësishëm:

- ✓ Krijimi i Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, që do të monitorojë dhe menaxhojë në mënyrë më të mirë këto kategori të prekshme.
- ✓ Rritja e bashkëpunimit me policinë dhe institucionet e tjera, për të siguruar një monitorim më të saktë dhe për të rritur ndërgjegjësimin rreth këtij problemi në komunitet.
- ✓ Fushata ndërgjegjësimi në zonat më të rrezikuara, për të ulur stigmën dhe frikën e raportimit nga individët e prekur nga varësitë.
- ✓ Zhvillimi i programeve të veçanta rehabilitimi dhe mbështetjeje, që përfshijnë terapi psikologjike dhe mbështetje sociale, duke i dhënë personave të prekur mundësinë për një rikuperim të plotë.

Pa një qasje më të strukturuar dhe të mirëkoordinuar, sfidat për përballimin e varësive nga droga dhe alkooli në Bashkinë Rrogozhinë do të vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura. Krijimi i një njësie të specializuar dhe bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha institucionet relevante do të sigurojnë që të gjithë individët që përballen me këto sfida të kenë mbështetjen e nevojshme. Vetëm kështu, Bashkia do të jetë në gjendje të ofrojë shërbime të qëndrueshme dhe efektive për këtë kategori vulnerabël, duke siguruar një plan social më të mirë për të gjithë qytetarët e saj.

1.2.9 Persona LGBTIQ+

Në planet sociale të mëparshme të Bashkisë Rrogozhinë, personat LGBTIQ+ nuk janë identifikuar apo përfshirë në asnjë fazë të planifikimit dhe mbështetjes sociale. Kjo mungesë e thellë e të dhënave dhe fokusit institucional ka krijuar një boshllëk në ofrimin e shërbimeve për këtë kategori, duke lënë pas dore jo vetëm nevojat e tyre specifike, por edhe përballjen me sfida të tilla si diskriminimi dhe përjashtimi social.

Për të përmbushur detyrimet e saj dhe për të siguruar një mbrojtje të plotë dhe të integruar për këta individë, Bashkia Rrogozhinë duhet të krijojë urgjentisht Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, një strukturë e detyruar nga Ligji Nr. 121 për Shërbimet Shoqërore, e cila jo vetëm që do të ndihmonte në krijimin e një baze të dhënash për personat LGBTIQ+, por edhe në përcaktimin e qartë të nevojave dhe sfidave të tyre. Kjo njësi duhet të vendosë protokolle bashkëpunimi me organizata të specializuara të shoqërisë civile dhe institucione publike si arsimit, shëndetësisë dhe policia, për të mbështetur një qasje të integruar dhe për të garantuar ofrimin e shërbimeve sociale të personalizuara dhe të qëndrueshme për personat LGBTIQ+.

Për më tepër, krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe mbikëqyrjes së diskriminimit është thelbësor për të mbrojtur të drejtat e këtij grupi vulnerabël. Këta mekanizma duhet të përfshijnë mbështetje psikologjike, juridike dhe sociale, si dhe fushata ndërgjegjësimi për të rritur tolerancën dhe përfshirjen në komunitet. Krijimi i një platforme të konsultimit publik dhe përfshirja e zërit të personave LGBTIQ+ në vendimmarrje është gjithashtu një hap thelbësor për të garantuar që politikat dhe programet që hartohen përfshijnë nevojat reale të kësaj kategorie.

Pa krijimin e këtyre strukturave dhe përmirësimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave, Bashkia Rrogozhinë rrezikon të mbetet pas në adresimin e sfidave të barazisë dhe përfshirjes sociale. Prandaj, është e rëndësishme që ky boshllëk të mbushet dhe që personat LGBTIQ+ të trajtohen me të njëjtën vëmendje dhe përkushtim si çdo kategori tjetër në komunitet, duke siguruar një ambient social të drejtë, të barabartë dhe të përfshirës për të gjithë.

II Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve

1. Hartëzimi i shërbimeve

Shërbimet sociale në Bashkinë Rrogozhinë përqendrohen aktualisht në një formë unike të ofrimit të tyre përmes një shërbimi lëvizës, i cili mbulon të gjithë territorin e bashkisë. Ky shërbim lëvizës financohet nga Fondi Social dhe Bashkia Rrogozhinë, duke synuar të mbulojë nevojat bazë të grupeve vulnerabël. Ofertat kryesore të shërbimeve përfshijnë psikoterapi, fizioterapi dhe infermieri, të cilat janë shërbime të rëndësishme për përmirësimin e mirëqenies fizike dhe mendore të përfituesve. Gjithashtu, gjatë periudhës 2021-2022, është ofruar dhe shërbimi i logopedisë, një element kyç për fëmijët me vështirësi të folurit dhe të zhvillimit të gjuhës.

Ky model i shërbimit lëvizës ka një impakt të gjerë, pasi është i pranishëm në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke përfshirë zonat rurale dhe ato të largëta që shpesh mbeten të pa mbuluara nga shërbime të tjera. Mbështetja e shërbimeve thelbësore, si ato terapeutike dhe mjekësore, përmes këtij modeli lëvizës, ndihmon në përmbushjen e nevojave emergjente të komunitetit në fushën e shëndetit dhe mirëqenies.

Një sfidë e rëndësishme që Bashkia Rrogozhinë përballet është mungesa e një strukture të posaçme për monitorimin e shërbimeve sociale që ofron. Aktualisht, nuk ka një sistem të mirëorganizuar për të mbledhur të dhëna dhe për të vlerësuar cilësinë dhe impaktin e shërbimeve lëvizëse, si psikoterapia, fizioterapia dhe infermiera. Mungesa e monitorimit të rregullt krijon vështirësi në identifikimin e nevojave reale të komunitetit dhe në përmirësimin e shërbimeve ekzistuese. Për të adresuar këtë boshllëk, Bashkia duhet të ndërmarrë hapa për krijimin e një mekanizmi monitorimi dhe vlerësimi, i cili do të mundësojë rritjen e transparencës dhe efektivitetit të shërbimeve sociale, duke siguruar që ato të përshtaten me nevojat në ndryshim të komunitetit

III Boshllëqet – nevojat e paplotësuara për kujdes social dhe shërbimet

Në Bashkinë Rrogozhinë, identifikimi i boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve sociale është një hap i domosdoshëm për të adresuar nevojat e individëve dhe familjeve në situata vulnerabiliteti. Aktualisht, situata tregon se vetëm një shërbim lëvizës ofrohet për individët dhe familjet në nevojë, ndërsa pagesat e mbështetjes ekonomike bëhen në formën e CASH-it. Mungesa e shërbimeve sociale për kategoritë e tjera të grupeve vulnerabël, si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarit, është evidente dhe kërkon një vëmendje të menjëhershme.

Grupi i Prekur dhe Boshllëqet Identifikuese

Individët mbi 18-65 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike (500 individë): Aktualisht, ata përfitojnë vetëm nga një program për fuqizimin ekonomik, por nuk kanë akses në kurse

formuese për zhvillimin e aftësive profesionale dhe zanateve, gjë që do të ndihmonte në integrimin e tyre në tregun e punës.

Punëkërkuetit (982 të regjistruar): Mungon një sistem i organizuar i këshillimit dhe informimit për punësim, për t'i orientuar ata në mundësi reale punësimi dhe në zhvillimin e aftësive që kërkohen nga tregu.

Personat me aftësi të kufizuara (446): Nuk ofrohen shërbime rehabilituese adekuate dhe as mbështetje për integrimin e tyre në komunitet. Ndalimi në shërbimet ditore dhe mbështetjen për kujdesin e nevojshëm është një boshllëk i dukshëm.

Fëmijët në nevojë për mbrojtje (87): Mungojnë shërbimet e specializuara dhe qendrat ditore që do të ofronin një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e tyre. Këto boshllëqe ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijëve dhe rritin rrezikun e dhunës dhe abuzimeve.

Të moshuarit në nevojë për shërbime (682): Pavarësisht numrit të lartë, shërbimet për ta janë shumë të limituara, duke përfshirë vetëm shërbime në familje dhe qendra për argëtim, pa ofruar mbështetje të plotë për kujdesin dhe nevojat e tyre specifike.

Individët viktimë të dhunës në familje (13): Shërbimet e ofruara janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat e këtyre individëve, duke përfshirë mungesën e strehimit të sigurt dhe të mbrojtur.

Për të përmirësuar situatën e ofrimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Rrogozhinë dhe për të adresuar boshllëqet ekzistuese, është thelbësore të ndërmerren disa veprime strategjike.

Së pari, zgjerimi i shërbimeve është një hap i domosdoshëm. Bashkia duhet të zhvillojë dhe ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh sociale, duke përfshirë qendra ditore për fëmijët, shërbime rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetje të veçantë për të moshuarit. Këto shërbime do të kontribuonin në rritjen e mirëqenies së grupeve vulnerabël dhe do të ofronin një mbështetje të qëndrueshme për ata që kanë nevojë.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm është krijimi i një programi të strukturuar për këshillimin dhe orientimin për punësim. Ky program do të ndihmonte në integrimin e punëkërkuetve në tregun e punës, duke i ofruar atyre mundësitë dhe informacionin e nevojshëm për të gjetur vende pune të përshtatshme për aftësitë dhe nevojat e tyre.

Për më tepër, është e nevojshme të rritet vetëdija dhe informimi në komunitet mbi shërbimet e disponueshme. Një fushatë informuese do të ishte thelbësore për të siguruar që individët e interesuar të kenë njohuri të plota mbi mënyrat e përfitimit nga këto shërbime, duke rritur kështu aksesin e tyre në to.

Së fundmi, është domosdoshmër ndërtimi i një qendre për ofrimin e një strehimi të sigurt dhe shërbimeve mbështetëse për individët në nevojë që t'i ndihmonte ata të rindërtojnë jetën e tyre dhe të gjejnë siguri dhe mbështetje në një moment të vështirë.

Këto rekomandime përbëjnë një bazë të fortë për përmirësimin e sistemit të shërbimeve sociale në Bashkinë Rrogozhinë, duke u fokusuar në nevojat e grupeve vulnerabël dhe duke ofruar mbështetje të qëndrueshme dhe të përshtatshme për ta.

IV Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta

4.1 Analiza e burimeve njerëzore

Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Rrogozhinë mbulon të gjithë territorin e bashkisë, përfshirë njësitë administrative, duke ndjekur kërkesat ligjore. Aktualisht, bashkia ka një **punonjës për mbrojtjen e fëmijëve** dhe një **koordinator dhune**, të cilët mbulojnë detyrat specifike për këto kategori vulnerabël. Megjithatë, ka disa mungesa dhe sfida të rëndësishme që pengojnë ofrimin efektiv të shërbimeve sociale dhe përmbushjen e nevojave të ndryshme të komunitetit.

Së pari, mungon **Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave**, një strukturë e domosdoshme për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e rasteve të nevojshme për mbështetje. Krijimi i kësaj njësie është thelbësor për të siguruar një trajtim të duhur dhe koordinuar për të gjitha grupet në nevojë në bashki, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe grupet e tjera vulnerabël.

Një tjetër sfidë e rëndësishme është mungesa e **specialistëve të dedikuar për trajtimin e çështjeve që lidhen me moshën e tretë dhe çështjet që prekin komunitetet rome dhe egjiptiane**. Duke pasur parasysh përqindjen e lartë të të moshuarve dhe të komuniteteve rome dhe egjiptiane në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, nevoja për specialistë të dedikuar për këto grupe mbetet një boshllëk i rëndësishëm në strukturën e burimeve njerëzore. Pa këto role të specializuara, është e vështirë të ofrohen shërbime të personalizuara dhe të adekuata për nevojat e këtyre grupeve.

Një tjetër çështje e rëndësishme që kërkon vëmendje është fakti që **rregullorja e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale nuk është rishikuar**, dhe **përshkrimet e detyrave të punonjësve nuk janë azhurnuar** sipas ndryshimeve ligjore të fundit. Kjo sjell mungesë qartësie në rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve të shërbimeve sociale dhe mund të ndikojë në performancën e përgjithshme të drejtorisë, duke rrezikuar cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Për të përmirësuar situatën aktuale të burimeve njerëzore, është e nevojshme:

- **Krijimi dhe funksionalizimi i Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit** për të përmirësuar identifikimin dhe ndihmën për grupet në nevojë.
- **Rekrutimi i specialistëve** për të mbuluar nevojat e veçanta të të moshuarve dhe komuniteteve rome dhe egjiptiane.
- **Rishikimi dhe azhurnimi i rregullores dhe përshkrimeve të detyrave**, duke siguruar përputhjen e tyre me legjislacionin në fuqi dhe duke qartësuar përgjegjësitë për çdo pozicion.

Me një ristrukturim dhe shtim të burimeve njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale do të jetë në gjendje të ofrojë shërbime më të plota, të koordinuara dhe efektive për qytetarët e Bashkisë Rrogozhinë.

Analiza PESTLE

Faktori politik:

Faktori ekonomik:

Faktori social:

Faktori teknologjik:

Faktori ligjor:

Faktori mjedisor:

Analiza SËOT

Pikat e Forta:

- ✓ Strukturë e ngritur për mbulimin e territorit: Bashkia ka një rrjet shërbimesh që mbulon të gjitha njësitë administrative, duke ofruar mbështetje në zona rurale dhe urbane. Kjo mund të forcohet duke shtuar koordinimin ndërmjet njësive dhe përmirësuar monitorimin e cilësisë së shërbimeve në zonat më të largëta.
- ✓ Specialistë të dedikuar për fëmijët dhe dhunën: Ekzistenca e një punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe një koordinatori dhune siguron që këto çështje të trajtohen me prioritet. Trajnimi i mëtejshëm i këtyre specialistëve dhe zgjerimi i kompetencave të tyre për të përfshirë mbështetje më të gjerë për të gjitha grupet vulnerabel, do të ishte një hap pozitiv.
- ✓ Përputhshmëri me legjislacionin kombëtar: Plani social ndjek standartet kombëtare dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030. Duhet krijuar një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të këtyre standarteve për të siguruar rezultate të qëndrueshme.
- ✓ Përfshirja e njësive administrative: Përfshirja e njësive në ofrimin e shërbimeve rrit aksesin për banorët në çdo pjesë të bashkisë. Forcimi i kapaciteteve lokale nëpër njësitë administrative për të garantuar që të gjitha zonat të marrin shërbime të një cilësie të lartë.

Pikat e Dobëta:

- ✓ Mungesa e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të nevojave: Pa këtë strukturë, nuk ka një vlerësim të plotë dhe të strukturuar të nevojave sociale të popullsisë. Krijimi i kësaj njësie do të ndihmonte në përmirësimin e diagnozës së nevojave dhe në alokimin e drejtë të burimeve.
- ✓ Mungesa e specialistëve për grupe specifike: Bashkia nuk ka specialistë për të moshuarit, romët dhe egjiptianët, që kufizon mundësinë për ofrimin e mbështetjes

specifike. Duhet të parashikohet rekrutimi i specialistëve të rinj dhe krijimi i programeve për trajnimin e stafit ekzistues mbi nevojat specifike të këtyre grupeve.

- ✓ Rregullore të paazhornuara: Përshkrimet e detyrave të stafit nuk janë azhornuar sipas ndryshimeve ligjore, duke krijuar paqartësi në role dhe përgjegjësi. Azhornimi i rregullores dhe krijimi i një strukture të qartë të përgjegjësive do të përmirësojë efikasitetin dhe përgjegjshmërinë në kryerjen e detyrave.
- ✓ Buxhet i kufizuar për shërbimet sociale: Pa fonde të mjaftueshme, mund të jetë e vështirë të ofrohen shërbime të plota për të gjitha grupet vulnerabël. Duhet bërë një rishikim i buxhetit për të garantuar një ndarje më të madhe të fondeve për shërbimet sociale dhe për të kërkuar fonde nga donatorë të jashtëm.

Mundësitë:

- ✓ Akses në fonde nga donatorë dhe qeveria: Ka mundësi për të shfrytëzuar financimet nga donatorë ndërkombëtarë dhe organizata jo-qeveritare për të plotësuar boshllëqet e financimit. Krijimi i një ekipi të specializuar për aplikimet në projekte ndërkombëtare mund të sjellë fonde shtesë për zgjerimin e shërbimeve.
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve për staf : Trajnimet e specializuara për stafin do të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve dhe do të adresojnë boshllëqet e njohurive. Bashkia duhet të krijojë një program të vazhdueshëm trajnimi për stafin, duke përfshirë tema të tilla si menaxhimi i rasteve, trajtimi i moshuarve dhe qasjet për komunitetet rome dhe egjiptiane.
- ✓ Përmirësimi i shërbimeve për të moshuarit dhe vulnerabël: Ekziston mundësia për të krijuar struktura të reja për mbështetjen e të moshuarve dhe të grupeve vulnerabël. Krijimi i qendrave komunitare ose programeve mobile të shërbimeve sociale për të ofruar mbështetje direkte për grupet vulnerabël.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve: Mund të forcohet koordinimi ndërmjet institucioneve vendore dhe organizatave jo-qeveritare për të optimizuar shërbimet. Themelimi i një tryeze të përbashkët koordinimi midis bashkisë dhe aktorëve të tjerë socialë do të ndihmonte në zbatimin e një qasjeje më të integruar.

Rreziqet:

- ✓ Mungesa e fondeve të qëndrueshme: Nëse nuk sigurohet financim i mjaftueshëm, përmirësimet e planifikuara mund të mbeten të papërmbyshura. Diversifikimi i burimeve të financimit dhe krijimi i një plani afatgjatë për sigurinë financiare të shërbimeve sociale.
- ✓ Rritja e kërkesave për shërbime: Me plakjen e popullsisë dhe përkeqësimin e kushteve ekonomike, kërkesat për shërbime sociale do të rriten, çka mund të mbingarkojë strukturën ekzistuese. Hartimi i një plani të parashikimit të kërkesave dhe rritja graduale e kapaciteteve do të ndihmojë në përballimin e rritjes së kërkesave.
- ✓ Mungesa e specialistëve të mjaftueshëm: Pa rekrutimin e mjaftueshëm të specialistëve, disa segmente të popullsisë mund të mbeten pa shërbime adekuate. Krijimi i programeve për rekrutimin dhe mbajtjen e specialistëve socialë, duke përfshirë stimuj financiarë dhe mundësi zhvillimi profesional.
- ✓ Mungesa e koordinimit ndërinstitucional: Pa një koordinim të mirë ndërmjet aktorëve të ndryshëm, ofrimi i shërbimeve mund të jetë i fragmentuar dhe joefektiv. Krijimi i mekanizmave të rregullt të takimeve dhe raportimeve mes institucioneve për të garantuar që shërbimet janë të integruara dhe efektive.

III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë është të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve sociale, i cili synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e mbrojtjes për të gjithë qytetarët. Plani do të përqendrohet në fuqizimin e individëve nga grupet më të cenueshme dhe të marginalizuara, duke ofruar mundësi rinteprimit dhe përmirësimi të jetës për ata që përballen me sfida të ndryshme, përfshirë fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, gratë dhe vajzat, individët me aftësi të kufizuar, si dhe ata që kanë qenë viktime të dhunës ose trafikimit. Gjithashtu, do të adresohen nevojat e individëve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke krijuar një ambient mbështetës që garanton dinjtet dhe akses në shërbime për të gjithë.

Për të arritur këto synime, plani parashikon një sërë objektivash dhe masash konkrete që do të zbatohen në nivel lokal konkretisht:

Objektivi Specifik 1

Objektivi Specifik 1: Të rritet cilësia e shërbimeve për grupet në nevojë duke forcuar kapacitetet dhe aftësitë e personelit të sektorit të shërbimeve sociale.

Masa 1: Forcimi i kapacitetit institucional dhe përmirësimi i strukturave të shërbimeve sociale për të adresuar nevojat e grupeve vulnerabël.

- ✓ Aktivitet 1.1: Rishikimi i rregullores ekzistuese dhe përfshirja e kërkesave ligjore në strukturën dhe organikën e departamentit të shërbimeve sociale, për të siguruar përputhjen me standardet kombëtare dhe për të adresuar nevojat në rritje të grupeve vulnerabël.
- ✓ Aktiviteti 1.2: Organizimi i sesioneve trajnimit për stafin e shërbimeve sociale mbi nevojat dhe sfidat specifike të grupeve vulnerabël, përfshirë komunitetet rom dhe egjiptiane.
- ✓ Aktivitet 1.3: Krijimi dhe zhvillimi i një databaze të centralizuar për identifikimin dhe evidentimin e kategorive në nevojë, duke përfshirë nevojat specifike të tyre, për të mundësuar planifikimin më të saktë dhe ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë të targetuar dhe efektive.

Masa 2: Vlerësimi i performancës dhe monitorimi i shërbimeve

- ✓ Aktivitet 2.1: Hartimi i një protokollit për monitorimin e shërbimeve sociale, i cili do të përcaktojë kriteret dhe standardet e cilësisë për ofrimin e shërbimeve, si dhe do të përfshijë mekanizmat për vlerësimin e efektivitetit dhe ndikimit të tyre në grupet në nevojë.

- ✓ Aktivitet 2.2: Realizimi i anketave dhe intervistave me përfituesit e shërbimeve për të marrë feedback mbi cilësinë e ofrimit të shërbimeve.
- ✓ Aktivitet 2.3: Analiza periodike e rezultateve të vlerësimit dhe integrimi i rekomandimeve në praktikën e punës të personelit.

Masa 3: Krijimi i rrjeteve bashkëpunimi

- ✓ Aktivitet 3.1: Fuqizimi i grupeve teknike për fëmijët dhe rastet e dhunës, si dhe ngritja e grupeve teknike për trajtimin e situatave të tjera emergjente, duke përfshirë bashkëpunimin ndërinstitucional për një reagim më të shpejtë dhe efektiv ndaj nevojave emergjente.
- ✓ Aktivitet 3.2: Organizimi i takimeve të rregullta midis sektorëve të ndryshëm për të diskutuar sfidat dhe zgjidhjet në ofrimin e shërbimeve sociale.
- ✓ Aktivitet 3.3: Inkurajimi i shkëmbimit të praktikave më të mira mes specialistëve të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe kombëtar.

Objektivi Specifik 2

Objektivi Specifik 2: Përmirësimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale për të gjithë grupet në nevojë, duke rivitalizuar shërbimin për personat me aftësi të kufizuara ekzistues dhe duke ndërtuar shërbime të reja në përgjigje të kërkesave për grupet në nevojë.

Masa 1: Rivitalizimi i shërbimit për personat me Aftësi të Kufizuara

- ✓ Aktivitet 1.1: Analiza e nevojave të personave me aftësi të kufizuara për të identifikuar mangësitë dhe mundësitë për përmirësim në shërbimet ekzistuese.
- ✓ Aktivitet 2.2: Zgjerimi dhe rindërtimi i shërbimit për personat me aftësi të kufizuara, duke shtuar gamën e shërbimeve bazuar në analizën e nevojave të identifikuara në Aktivitetin 1, me fokus në përmirësimin e aksesit dhe mbështetjes së tyre në jetën e përditshme.

Masa 2: Zhvillimi i Shërbimeve për familjen, fëmijët dhe të rinjtë, individë në nevojë ekstreme

- ✓ Aktivitet 2.1: Planifikimi dhe alokimi i fondeve të dedikuara nga buxheti i bashkisë për menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve në rrezik
- ✓ Aktiviteti 2.2: Ngritja e qendrës për mbështetjen e për familjen, fëmijët në nevojë dhe të rinjtë në Njësinë Administrative Gosë, ku ata mund të marrin asistencë psikologjike dhe zhvillim personal.
- ✓ Aktiviteti 2.3: Ndërtimi i qendrës multifunksionale mbështetëse për individët në nevojë në kushte ekstreme jetese
- ✓ Aktivitet 2.4: Organizimi i aktiviteteve edukative dhe kulturore për fëmijët dhe të rinjtë e grupeve vulnerabël, për të promovuar integrimin dhe vetëbesimin.

Masa 3: Ofrimi i shërbimeve për të moshuarit

- ✓ Aktivitet 3.1: Ngritja e shërbimit ditor “Kafe me gjyshin” në 5 njesite administrative të Bashkisë Rrogozhie

Masa 4: Mbështetje për viktimat e dhunës dhe trafikimit

- ✓ Aktivitet 4.1: Planifikimi dhe alokimi i fondeve të dedikuara nga buxheti i bashkisë për menaxhimin efektiv të rasteve të dhunës, duke përfshirë mbështetjen emergjente, rehabilitimin dhe shërbimet e integruara për viktimat.
- ✓ Aktivitet 4.2: Ofrimi i trajtimeve psikosociale dhe rehabilitimit për viktimat e dhunës dhe trafikimit, duke ndihmuar në rikthimin e tyre në shoqëri.
- ✓ Aktivitet 4.3: Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuëse për të informuar publikun mbi problematikën e dhunës dhe trafikimit, duke inkurajuar raportimin dhe mbështetje për viktimat.

Masa 5: Mbështetje e Integruar për Komunitetin Rom dhe Egjiptian

- ✓ Aktiviteti 5.1 Krijimi i një sistemi regjistrimi për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, duke evidentuar nevojat specifike të tyre për shërbime sociale dhe mbështetje.
